

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 8, neni 20 paragrafi 1 alineja 11, në lidhje me nenin 52 dhe nenin 93 paragrafi 3 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14) dhe nenit 15 paragrafi 1 alineja 7 dhe neni 39 paragrafi 1 alineja 3 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele nr. 01-4351/1 nga data 29.08.2014, e në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. 02-6126/4 nga data 12.12.2014, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në mbledhjen e saj të 21-të, të mbajtur më 12.12.2014, miratoi

RREGULLORE
PËR PROGRAMET ME PJESMARRJE SHPËRBLYESE DHE
PËR PËRDORIMIN E SHËRBIMEVE TELEFONIKE ME VLERË TË SHTUAR

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Lëndë

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e zbatimit të dispozitave nga:

- Neni 52 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në lidhje me obligimin e ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele të sigurojnë publikimin pa hamendje të rregullave për programet me pjesëmarrje shpërblyese dhe për shpërblimin e premtuar publik; dhe
- Neni 93 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në lidhje me rregullat për përdorimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar.

Neni 2

Definicionet

Shprehje të caktuara, që janë përdorur në këtë Rregullore e kanë këtë domethënie:

1. **Programe me pjesëmarrje shpërblyese** janë të gjitha llojet e programeve ose pjesëve të tyre në të cilat ofrohet ose ndahet shpërblim i çfarëdo lloji (prodhim, shpërblim në para, udhëtime, shërbime, këshillë nga udhëheqësi i programit etj.), pa marr parasysh nëse shpërblimi ju ndahet pjesëmarrësve (mysafirëve) në program (të pranishëm fizikisht në studio) ose shikuesve ose dëgjuesve që marrin pjesë në program përmes shërbimit telefonik me vlerë të shtuar, ose përmes lidhjes së thjeshtë telefonike.
2. **Shërbime telefonike me vlerë të shtuar** janë shërbimet telefonike nga telefonia fikse dhe ajo mobile, përfshirë edhe votimin telefonik, SMS dhe MMS shërbimet, për të cilat paguhet çmim më i lartë nga i zakonshmi për atë lloj shërbimi, pa marrë parasysh numrin përmes të cilit është realizuar shërbimi.
3. **Votimi telefonik** është votimi i shikuesve ose dëgjuesve përmes telefonit, pa marrë parasysh nëse përdoret shërbim telefonik me vlerë të shtuar ose paguhet tarifa e zakonshme e thirrjeve të realizuara.

II. RREGULLAT PËR PROGRAMET ME PJESMARRJE SHPËRBLYESE

Neni 3

Rregullat për organizimin e programeve me pjesëmarrje shpërblyese

Ofruesi i shërbimit mediatik audio dhe audiovizuel, për emetimin e programeve me pjesëmarrje shpërblyese është i obliguar që të miratojë rregulla që i publikon në ueb faqen e saj dhe për të cilën e informon Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

Rregullat për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele duhet të përmbajnë dispozita për këto aspekte të programit:

- Përshkrimin e grupit të shikuesve/dëgjuesve për të cilët është dedikuar programi konkret;
- Përshkrim i detajuar i mënyrës së pjesëmarrjes në program dhe mënyrën se si fitohet shpërblim;
- Shpenzimet për pjesëmarrje në program;
- Kufizime eventuale për pjesëmarrje në program për individ (si p.sh: të punësuarit të ofruesit i shërbimit dhe anëtarët e familjeve të tyre etj);
- Kufizime eventuale të përgjithshme për pjesëmarrje në program: kohëzgjatja e lojës/garës, numri maksimal i pjesëmarrësve, numri maksimal i pjesëmarrësve gjatë një edicioni të programit, periudha kohore që duhet të kalohet për pjesëmarrje të sërishme në program pas fitimit të një shpërblimi etj;
- Mënyra se si i ndahet shpërblimi fituesit;
- Vlera mesatare e shpërblimeve që ndahen në program;
- Mënyra se si shpallen fituesit e garës ose lojës;
- Mënyra se si shikuesit/dëgjuesit njoftohen për përfundimin e garës ose lojës;
- Mënyra dhe periudha në të cilën shpërblimi i dorëzohet fituesit pa shpenzime shtesë, respektivisht procedura me të cilën fituesi mund të kërkojë ti dorëzohet shpërblimi;
- Mënyra se si do të menaxhohen të dhënat personale të pjesëmarrësve në program dhe fituesve të shpërblimeve.

Neni 4

Informimi i shikuesve dhe dëgjuesve për rregullat

Ofruesi i shërbimit mediatik audio dhe audiovizuel, gjatë emetimit të programeve me pjesëmarrje shpërblyese, duhet qartë dhe pa hamendje ti informojë shikuesit dhe dëgjuesit së paku për:

- Mënyrën dhe shpenzimet për pjesëmarrje në program;
- Kufizimet për pjesëmarrje në program;
- Lloji i shpërblimit, mënyra e ndarjes dhe mënyra dhe periudha e dorëzimit të dhuratës së fituesit; dhe
- T'i përkujtojë se rregullat e plota për pjesëmarrje në program ose në një pjesë të saj mund të gjenden në ueb faqen e ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizuel.

Nëse në program me pjesëmarrje shpërblyese, përmes telefonit, mund të marrin pjesë shikuesit ose dëgjuesit, ofruesi i shërbimit mediatik audio ose audiovizuel është i obliguar që qartë dhe pa hamendje ti informojë për:

- Pyetjen të cilës duhet ti përgjigjen (patjetër duhet t'u parashtrohet qartë dhe në mënyrë të kuptueshme);

- Llojin dhe numrin e shpërblimeve që mund të merren (nëse fitimi i shpërblimit është i kushtëzuar me shpenzime shtesë për fituesin, për këtë shikuesit ose dëgjuesit duhet qartë të informohen- p.sh, qëndrim në hotel ku është paguar vetëm bujtina, ose përdorimi i shërbimit vjetor ku janë të paguar vetëm tre muajt e parë);
- Mënyra e pjesëmarrjes në lojë ose garë (qoftë me thirrje telefonike ose me SMS porosi, shikuesi/dëgjuesi në mënyrë automatike fiton mundësinë që ti përgjigjet pyetjes dhe të fitojë shpërblim ose duhet që në mënyrë plotësuese të presë, të paraqitet përsëri etj; nëse një person mund të marrë pjesë më shumë herë në të njëjtën lojë shpërblyese; nëse fituesi është shikues/dëgjuesi i cili do të paraqitet më së shpejti dhe do të japë përgjigje të saktë ose emri i fituesit do të tërhiqet nga të gjithë pjesëmarrësit që janë përgjigjur saktë në atë pyetje etj.);
- Kohëzgjatja e lojës ose garës (kohës kur shikuesit/dëgjuesit mund të fillojnë të paraqiten dhe koha kur duhet të ndërpresin atë, sepse thirrjet e tyre (ose porositet) nuk do të merren parasysh);
- Ku (në cilën ueb faqe) mund të gjenden në rregullat e plota për pjesëmarrje në program ose në një pjesë të saj, të krijuara nga ofruesit e shërbimit mediatik audio ose audiovizuel.

Në rast të emetimit të sërishëm të programit, respektivisht reprizës së saj, shikuesit/dëgjuesit duhet patjetër qartë ta informojnë se bëhet fjalë për reprizë të programit dhe se nuk duhet të paraqiten në numrat e telefonit sepse loja, kuisi, gara ose programi konkret ka përfunduar.

Neni 5

Mënyra e prezantimit të shpërblimeve në programe

Gjithmonë kur në ndonjë program ose pjesë të saj ofrohet shpërblim, pa marrë parasysh se çfarë lloji të programit ose se për çfarë pjesëmarrje në program bëhet fjalë, shpërblimi mund të prezantohet në atë mënyrë që me gojë do të përmendet ose vizualisht do të tregohet emri ose lloji i prodhimit ose personit juridik që e siguron shpërblimin.

Përmendja ose pasqyrimi nuk guxon që të bëhet në mënyrë jo të natyrshme, të tepërt ose në mënyrë ngurruese me çka dukshëm të theksohet ose promovohet prodhimi, marka, shërbimi ose personi juridik që e siguron shpërblimin.

Nuk lejohet përdorimi i komenteve lavdëruese për kualitetin e shpërblimit, çmimi i saj ose se a është në dispozicion, si dhe çfarëdo shprehje tjera promovuese. Shikuesit ose dëgjuesit nuk duhet të nxiten ose të këshillohen që ta blejnë ose ta huazojnë shpërblimin.

Neni 6

Mbrojtja e të miturve

Të gjitha llojet e programeve me pjesëmarrje shpërblyese ose pjesë të tyre duhet patjetër të harmonizohen me dispozitat për mbrojtjen e të miturve, nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele dhe me Rregulloren për mbrojtjen e personave të mitur ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 172/14).

Nëse ndonjë program me pjesëmarrje shpërblyese është kryesisht i dedikuar për (ose në të marrin pjesë) të mitur, ofruesi i shërbimit mediatik audio ose audiovizuel është i obliguar që për pjesëmarrjen e të miturit në program të kërkoj pëlqim nga prindi ose kujdestari i tij.

Karakterit i pjesëmarrjes së të miturve, përmbajtja e programit dhe shpërblimet duhet të jenë adekuate me moshën e personave të mitur.

Neni 7

Mbrojtja e privatësisë dhe të dhënave personale

Mbledhja, ruajtja dhe përdorimi i të dhënave personale të mbledhura gjatë programeve me pjesëmarrje shpërblyese duhet patjetër të bëhet në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/05, 103/08, 124/10, 135/11 dhe 43/14) dhe akteve nënligjore të miratuara nga Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale.

III. SHËRBIMEVE TELEFONIKE ME VLERË TË SHTUAR DHE VOTIMI TELEFONIK

Neni 8

Kushtet e përgjithshme

Ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele mund të përdorin shërbime telefonike me vlerë të shtuar dhe votim telefonik në të gjitha llojet e programeve, përveç në lajme, në programe informative dhe arsimore, në shërbime fetare dhe predikime dhe në programe për fëmijë.

Kur ofruesi i shërbimit mediatik audio ose audiovizuel organizon program ku do të përdorë shërbim telefonik me vlerë të shtuar, është i obliguar që në marrëveshjen e lidhur me ofruesin e shërbimit telefonik me vlerë të shtuar të përfshijë edhe dispozita me të cilat do të obligohet që të respektojë të gjitha dispozitat relevante ligjore dhe aktet nënligjore të miratuara nga Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele dhe nga Agjencia për komunikime elektronike.

Neni 9

Rregullat për organizimin e programeve në të cilat shfrytëzohen shërbime telefonike me vlerë të shtuar dhe votim telefonik

Ofruesi i shërbimit mediatik audio ose audiovizuel, për emetimin e programeve me ku përdoren shërbime telefonike me vlerë të shtuar dhe votim telefonik është i obliguar që të miratojë rregulla që i publikon në ueb faqen e saj dhe për të cilën e informon Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

Rregullat duhet të përmbajnë dispozita për këto aspekte të programit:

- Përshkrimi i programit dhe grupit të shikuesve/dëgjuesve për të cilët është dedikuar;
- Përshkrimi i mënyrës në të cilën realizohet pjesëmarrja e votuesve/dëgjuesve në program dhe shpenzimet;
- Kufizime eventuale për pjesëmarrje në program;
- Mënyra se si vlerësohen votat e publikut, respektivisht gjiri komisionit në program (nëse ka gjiri) dhe mënyra se si bëhet kontrolli i votimit, nëse bëhet fjalë për votim telefonik.

Neni 10

Shpenzimet për pjesëmarrje

Ofruesi i shërbimit mediatik audio ose audiovizuel, gjatë emetimit të programeve në të cilat përdoren shërbime telefonike me vlerë të shtuar, duhet patjetër qartë dhe pa hamendje ti informojë shikuesit dhe dëgjuesit për shpenzimet që do të kenë nga pjesëmarrja e tyre në program, në këtë mënyrë:

- Qartë ta theksojë (me gojë dhe/ose vizualisht) çmimin për çdo minutë bisede përmes shërbimit telefonik me vlerë të shtuar, duke e theksuar shumën e përgjithshme së bashku me tatimin e vlerës së shtuar.
- Nëse bëhet fjalë për lojë interaktive që zgjatë një periudhë më të gjatë kohore, disa herë gjatë programit, qartë duhet ti paralajmërojë shikuesit/dëgjuesit për shumën që do ta paguajnë pas përdorimit të tërë shërbimit;
- Në televizion, shpenzimet duhet të paraqiten qartë në ekran dhe të jenë të kumtuara me gojë, në mënyrë të kuptueshme dhe me ton neutral të zërit, kurse çmimi i përgjithshëm i shërbimit dhe numri telefonik duhet të shkruhen me font dhe madhësi të njëjtë;
- Në radio, shpenzimet duhet të kumtohen me gojë, disa herë gjatë programit, në mënyrë të kuptueshme dhe me ton neutral.

Ofruesi i shërbimit mediatik audio dhe audiovizuel për shpenzimet e bëra nga ana e dëgjuesve/shikuesve për pjesëmarrje në program përmes përdorimit të shërbimit telefonik me vlerë të shtuar, mund t'u paguaj, vetëm përmes llogarisë telefonike, e jo përmes kartelës kreditore ose në para të gatshme.

Neni 11

Votimi telefonik

Në programet në të cilat publikut i ofrohet mundësi që të marrë pjesë dhe të ndikojë në epilogun e fundit (të votojë për ndonjë nga garuesit në shou muzikor ose për ndonjë favorit të tyre në ndonjë shou tjetër etj), e ajo pjesëmarrje realizohet përmes shërbimit telefonik me vlerë të shtuar, ofruesi i shërbimit mediatik audio ose audiovizuel duhet patjetër që qartë dhe pa hamendje ti informojë shikuesit ose dëgjuesit për këtë:

- Se si do të kontribuojnë në program me votimin e tyre telefonik dhe se sa vlejné votat e tyre gjatë miratimit të vendimit final (nëse ka edhe gjiri dhe sa vlejné votat e gjirisë, e sa ato të publikut etj);
- Mënyra e votimit telefonik (nëse një person mund të marrë pjesë/votojë më shumë herë; nëse një person duhet të votojë më shumë herë që të japë një votë etj.);
- Shpenzimet për votimin telefonik (shumën e përgjithshme së bashku me tatimin e vlerës së shtuar);
- Kohëzgjatja e votimit telefonik (kohës kur shikuesit/dëgjuesit mund të fillojnë të paraqiten dhe koha kur duhet të ndërpresin atë, sepse thirrjet e tyre (ose porosinë) nuk do të merren parasysh);
- Mekanizimi për kontrollin e votimit (në cilën mënyrë mund të kontrollohet besueshmëria e votimit, kush e kryen atë kontroll etj);
- Ku (në cilën ueb faqe) mund të gjenden rregullat e plota për programin, të krijuara nga ofruesit e shërbimit mediatik audio ose audiovizuel.
- Në rast të emetimit të sërishëm, respektivisht reprizës së saj, shikuesve/dëgjuesve duhet patjetër që tu bëhet me dije qartë nëse ende është i mundshëm votimi telefonik, respektivisht qartë të theksohet se ka përfunduar.

Neni 12

Programe me shërbim telefonik me vlerë të shtuar kundrejt teleshoppingut

Nëse ofruesi i shërbimit mediatik audio ose audiovizuel i jep vlerë rëndësi të theksuar përdorimit të shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar në programet në të cilat marrin pjesë shikues dhe dëgjues të këtyre programeve, në pajtim me aktvendimin e Gjykatës Evropiane të drejtësisë në rastin CJUE, 18 octobre 2007, C-195/06, Kommunikationsbehörde Austria (KommAustria) c/ Österreichischer Rundfunk (ORF), do të konsiderohen si teleshopping.

Që të mos konsiderohet si teleshopping, programi në të cilin përdoret shërbimi telefonik me vlerë të shtuar duhet patjetër ti përmbush këto kushte:

- Të përbëhet kryesisht nga përmbajtje të formësuar redaktuese
- Qëllimi parësor i programit të jetë i paramenduar në mënyrë redaktuese;
- Aktiviteti komercial lidhur me përdorimin e shërbimit telefonik me vlerë të shtuar të jetë me rëndësi sekondare dhe të parëndësishme për përmbajtjen dhe qëllimin e programit;
- Produksioni i programit të mos jetë në tërësi ose gati se në tërësi i financuar nga të hyrat e fituara nga pjesëmarrja e shikuesve ose dëgjuesve përmes shërbimit telefonik me vlerë të shtuar.

IV. DISPOZITAT PËRMBYLLËSE

Neni 13

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore pushon vlefshmëria e Rregullores për përdorimin e shërbimeve telefonike në tarifë të veçantë në programet e radios dhe shërbimeve programore televizive ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/07).

Neni 14

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e ardhshme nga dita së publikimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë"

**Agjencia për shërbime
audio dhe audiovizuele**

Kryetar i Këshillit

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v

Nr. 01-6250/1
12.12.2014
Shkup